



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.60/2019
Prishtinë, më 14.3.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Lutfi Zharku, Hykmete Bajrami, Glauk Konjufca, Liburn Aliu, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë dhe Duda Balje, anëtare.

I ftuar: Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës dhe Transportit.

Pjesëmarrës: Argjend Zemaj, MIT; Sadri Jahaj dhe Musa Islamaj, INFRAPLUS; Liridon Gashi, SEEF; Besmir Radoniqi, KDI; Ardiana Mehmeti, KTV; Mirlind Behluli, T7; Drenushë Maxhuni, “Koha ditore”; Albana Hajdari, “Kosova post”; Besiana Bajrami, “Ekonomia online”; Nerënxa Jakupi, “Kosova press”; Visar Krasniqi, RTK; Blerta Ahmeti, Klan Kosova dhe Vaide Morina, Radio Kosova.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.2.2019;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe transportit, z. Pal Lekaj, për planifikimin e punëve dhe projekteve infrastrukturore për vitin 2019;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.2.2019

Procesverbali nga mbledhja e datës 26.2.2019, u miratuan pa vërejte

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe transportit, z. Pal Lekaj, për planifikimin e punëve dhe projekteve infrastrukturore për vitin 2019

Kryetarja, tha se edhe në kuadër të planit të punës që kemi miratuar për këtë vit, kemi paraparë raportimet e ministrave të linjës para komisionit, dhe në kuadër të këtij plani, është edhe sot ky raportim i ministrit z. Lekaj, në lidhje me planifikimin e punëve dhe projekteve infrastrukturore për vitin 2019.

Hykmete Bajrami, tha se është më e rëndësishme që të raportohet për projektet e realizuara në vitin 2018, se sa të flitet për planin e punës për vitin 2019 sepse pak a shumë e kemi të qartë edhe nga buxheti për vitin 2019.

Muharrem Nitaj, tha se pasi kjo pikë nuk është në rendin e ditës, dhe ky rend dite u miratua pa vërejtje, nuk mund të kërkojmë ndryshim tani, por kjo mund të caktohet në njërin nga mbledhjet e ardhshme, por nëse ministri është i përgatitur për të raportuar edhe për atë pikë, atëherë do ta mirëpresim.

Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, tha se si do që të vendosë komisioni, unë jam i gatshëm të raportoj. Ai theksoi se objektivat kyçe të ministrisë që drejton janë integrimi i Kosovës brenda rrjetit rajonal rrugor, zhvillimi i rrugëve 6 & 7 përgjatë korridoreve pan-evropiane, tani edhe autostrada e Dukagjinit (emërtim jo formal), nga Istogu deri në Prizren, zvogëlimi i shpenzimeve të transportit, rritja e sigurisë, zhvillimi i rrjetit dhe ulja e ngulfatjeve të rrjetit, përmes ndërtimit të rrugëve të reja që do të mundësojë trafikun transit, të anashkalojnë qendrat urbane dhe të zvogëlojnë kohën e udhëtimit, mirëmbajtja dhe përmirësimin i rrugëve ekzistuese që do të garantojë nivel të shërbimeve të transporti privat dhe publik në rrjetin rrugor, si dhe të ruajë asetet ekzistuese dhe investimet e bëra, përmirësimi i nivelit të sigurisë rrugore, me përmirësimin e kualitetit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, kualitetit të rrjetit të infrastrukturës rrugore, reduktimin e pikave të zeza dhe zhvillimin e kampanjave për sigurinë rrugore. Pastaj, ministri prezantoi projektet si vijon: vazhdimi i realizimit të projektit “Ndërtimi i Autostradës R6 / Prishtinë – Hani i Elezit”, buxheti i ndarë për vitin 2019 për përfundimin e këtij projekti është 51,500,000 euro; vazhdimi i realizimit të drejtimit rrugor 7 Morinë – Prishtinë - Merdare, segmenti Besi – Merdare, duke pasur parasysh që ky është projekt me prioritet për vitin 2019, planifikohet që në bashkëpunim me EIB dhe EBRD-në të vazhdohet me financimin e këtij projekti; autostrada Prishtinë – Gjilan – Konçul, R7.1, me gjatësi 47.1km, gjerësia 32 metra, që do të lidhë korridorin 6, 7 dhe 10, vlera e projektit 88 milionë euro, buxheti për vitin 2019, për këtë projekt është 23 milionë e 762 mijë euro (23.762.000 euro); vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugës nacionale N9, Prishtinë – Pejë (Segmenti, Kijevë – Zahaq), me fondet nga BERZH, Banka Investive Evropiane dhe Buxheti i Kosovës, vlera buxhetore në dispozicion për këtë projekt do të jetë rreth 200 milionë

euro. Projekti është i ndarë në tre lote dhe kurdo që të fillojë, e që besojmë aty rreth muajt maj të këtij viti, do të përfundojë për 24 muaj, apo për dy vite; vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugës nacionale N2, Prishtinë – Mitrovicë do të përfundojë me zgjerimin e rrugës nacionale N2, në drejtim të Mitrovicës deri në vitin 2021, ku për vazhdimin e këtij projekti në dispozicion i kemi 60 milionë dollarë kredi nga Banka Islamike për Zhvillim, Fondi Saudit për Zhvillim dhe OFID; zgjerimi i rrugës rajonale R - 102 dhe N – 25, në vitin 2014, Ministria e Infrastrukturës ka kontraktuar projektin "Zgjerimi i rrugës rajonale R102 Komoran – Skenderaj, segmenti: Klinë e Epërme – Morinë, i cili është i kontraktuar në shtatë lote, në gjatësi prej 13.01 km, ndërsa në vitin 2018 është vazhduar edhe me dy lote tjera të segmentit tjetër Morinë – Komoran, vlera e dy loteve që do të përfundojnë gjatë këtij viti është rreth 9.1 milionë euro, po ashtu planifikojmë që shumë shpejt të tenderojmë edhe pjesën e mbetur deri më Komoran dhe kështu do ta përmbyllim këtë segment; zgjerimi i rrugës rajonale N – 2 5 Podujevë – Prishtinë, gjatë vitit 2019 buxheti i ndarë për trajtimin e këtij projekti është rreth 3 milionë euro; zgjerimi i rrugës Dollc – Gjakovë, gjatë vitit 2019 buxheti i ndarë për realizimin e këtij projekti është rreth 7 milionë euro. Kjo autoudhë do të jetë e gjatë 32 kilometra; autostrada e Dukagjinit - autostrada që lidh shtatë komuna, Istog – Pejë – Decan – Junik – Gjakovë – Rahovec dhe që lidhet me autostradën "Ibrahim Rugova" në Prizren, është në fazën e projektimit. Kjo autostradë do të jetë e gjatë rreth 95 kilometra dhe do t'i ketë të gjitha elementet përcjellëse, katër shirita qarkullues me nga 3.75 metra = 15 metra; shiritin ndarës 3 metra të gjerë, dy shirita ndihmës (për ngadalësim dhe parkim emergjent të nevojshëm) me nga 2.5 metra të gjerë = 5 metra; shiritat për kyçje dhe çkyçje me nga 3.5 metra të gjerë dhe shumë elemente të tjera teknike, të cilat janë të përshkruara mirë në dosjen e projektit ideor. Në vitin 2018 ka filluar jetësimi i projektit "Zgjerimi i pistës dhe ngritja e sistemit të aterimit në Aeroportin "Adem Jashari" në Prishtinë, si investim në vlerë rreth 32.5 milionë euro, buxheti për vitin 2019 është i ndarë rreth 17,000,000 euro. Infrastruktura hekurudhore - investimet në infrastrukturë hekurudhore do të nisin së shpejti. Punët do të fillojnë në segmentin Fushë-Kosovë – Hani i Elezit. Tashmë, kontrata për fillimin e punimeve në këtë segment vetëm është nënshkruar dhe së shpejti do të kemi kontratë edhe për segmentin, Fushë-Kosovë – Leshak (Mitrovicë) dhe do të ketë zhvillime konkrete edhe për segmentin tjetër, atë nga Fushë-Kosova në drejtim të Pejës, si dhe po bëhet projekti në drejtim të Podujevës dhe kështu me radhë. Hekurudhat do të jenë funksionale për lëvizje të trenit deri në 120 kilometra në orë. Këto investime do të përfundojnë në vitin 2024 dhe sigurisht që kjo do të ndikojë në qarkullim më të lirë të njerëzve, por edhe të mallrave. Jemi duke i realizuar disa projekte tjera të infrastrukturës rrugore në lëmin e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrugëve. Mirëmbajtja e rrugëve dhe sinjalizimi i rrugëve nacionale dhe rajonale. Shtimi i sigurisë në komunikacionin rrugor është njëra nga objektivat me prioritet strategjik. Ministria e Infrastrukturës ka ndërmarrë një varg veprimesh dhe masash për të realizuar këtë objektivë. Si rezultat i zbatimit të Ligjit mbi sigurinë në komunikacionin rrugor, ndërtimit të nënkalimeve, përmirësimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si ministri, për vitin 2019 kemi nënshkruar një varg memorandumesh bashkëpunimi, me shumicën e komunave, si dhe në pjesën e dytë të vitit, presim të përmbyllet procesi i bashkëpunimi me të gjitha komunat e Kosovës.

Hykmete Bajrami, pyeti: Pse nuk është dënuar kompania "Bechtel&Enka", Për vonimin e punimeve, a ekziston një opinion i "Hill International", lidhur me pagesën e 53 milionë eurove? A ka pajtueshmëri mes partnereve të koalicionit për Autostradën e Dukagjinit, a ka studim të

fizibilitetit, cila është arseja e kësaj autostrade, kur kemi parasysh se të gjitha këto qytete që lidhen me autostradën e Dukagjinit kane lidhje shumë të lehte me autostradën që na lidh me Shqipërinë? Ndryshimi shumë i madh i çmimit të autostradave për kilometër, si ka mundësi që në rajone të ndryshme brenda Kosovës të ketë kaq shumë ndryshim të çmimit? Si e shpjegoni faktin se kompania e zëvendësit tuaj furnizon me beton kompanitë e kontraktuara për ndërtimin e autostradës së Gjilanit?

Liburn Aliu, tha se nuk mund të kuptoj se pse ka nevojë të ndërtohet autostrada Besi – Merdare, sepse kjo është në interes vetëm të Serbisë, kur e dimë se paralelisht është duke u ndërtuar rruga Prishtinë – Podujevë, me katër korsi. Jemi para kolapsit, si shtet, jemi duke bankrotuar. Pse duhet të mendohet që një autostradë me 4 katër korsi në Dukagjin, i zgjidh problemet? Deri në vitin 2025, pjesa më e madhe e buxhetit të shpenzohet në projekte infrastrukturore.

Lutfi Zharku, tha se jam i interesuar të di më shumë rreth kyçjeve në Bernicë dhe Ferizaj. Cili është qëndrimi i Qeverisë për këto dy kyçje? Më intereson ta di se deri ku ka shkuar procesi i testimit elektronik për patentë shofer, pse ka ngecur ky proces, kur e dimë rëndësinë që ka?

Veton Berisha, theksoi se e përkrah autostradën e Dukagjinit, duke pasur parasysh rëndësinë për banorët që i lidh kjo autostradë. Po ashtu, kërkoi informacione shtesë rreth segmentit Zahaq – Pejë, po ashtu për rrugën në fshatin Skivjan në Komunën e Gjakovës, ku ka banorë të komunitetit egjiptian dhe në atë pjesë ka afër 10 vjet që rruga është e gatshme, por ende nuk është asfaltuar, si dhe rruga në lagjen “Ali Ibraj”, ku e dini edhe ju që mungon rruga atje. A keni një plan për këto projekte dhe si janë planifikimet e juaja, si ministri, për këto rrugë?

Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, sa i përket kontratës R6, Prishtinë – Hani i Elezit, jemi detyruar ta kemi një aneks-kontratë deri më 31.12.2018 dhe kjo është bërë për punët fizike në përfundim të autostradës, dhe kur përmend 2019, është pasuesi tjetër i kontratës që ne jemi të obliguar t’i kryejmë të gjitha obligimet financiare, sepse ka qenë e pamundur të kryhen obligimet brenda vitit 2018. Ne jemi të obliguar t’i përfundojmë të gjitha pagesat më 1.6.2019. Kur të përfundojë i tërë projekti, do ta vlerësojmë sa ka pasur vonesa dhe arsyet pastaj do të kërkojmë barazimin me punëkryerësin. E jona është që ta zbatojmë në përpikëri atë që e kemi nënshkruar. Sa i përket opinionit të “Hill International”, ata thonë se nuk janë të thirrur që në aneks kontrate të vlerësojnë dhe nuk e ka pasur në kontratë. Ky është vlerësim zyrtar i tyre, kurse kur jemi të studimi i fizibilitetit për autostradën, ministri tha se nuk do të guxonim as të fillonim, pa një studim të tillë. Sa i përket involvimit të zëvendësministrit që u cek, unë njoh vetëm kontratën që është nënshkruar nga Zyra e prokurimit publik dhe nuk më intereson individi, sepse këtë e rregullon ligji për prokurim dhe nuk është puna ime që të vendos për kontrata. Sa i përket dallimit në çmime, është reliefi i terrenit që mund të ketë edhe dallime edhe në çmim. Sa i përket kyçjes, unë do ta implementoj vendimin e Komitetit Ndërministror, që të jenë edhe dy kyçje tjera, në Bernicë dhe në Ferizaj. Po ashtu, shpresoj se buxheti më i bëhet me “Bechtel & Enka”, pasi janë në punime në autostradë dhe shpresoj të bëhet zgjidhje për ata qytetarë, kurse testimi elektronik për patentë shofer, e them se është departamenti më i dobët, kanë thënë se teknologjia që përdoret nuk është e përshtatshme dhe për ata nuk mund të hyjë në funksion, por kam kërkuar dhe besoj se shumë shpejt do të funksionalizohet ky proces. Sa i përket pyetjes se jeni të fokusuar vetëm në projekte të mëdha,

ne kemi ndarë rreth 18 milionë euro për mbështetje të komunave, pa asnjë dallim politik, ndërsa sa i përket rrugës autostradës Prishtinë – Merdare, ne kemi përgjegjësi politike, sepse jemi dakorduar si tre shtete dhe duhet të përfundojë ky projekt. Sa i përket rrugës Zahaq – Pejë, ne jemi në fazën e përfundimit të këtij projekti, në një kohë shumë të shpejtë, kurse sa i përket lagjes “Ali Ibraj” dhe fshatit Skivjan, do të bëjmë një marrëveshje të veçantë për realizimin e këtyre projekteve.

Hykmete Bajrami, kërkoi arsytim se pse keni nxjerrë udhëzim administrativ, sa i përket homologimit, i cili i garanton monopolin kompanisë aktuale, dhe si i tillë, është kundërligjor. Pse, si institucion, duhet të kujdeseni që një kompanie private t’ia garantoni monopolin?

Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, pasi keni qenë vetë ministre dhe e dini natyrën e punës dhe e dini se ligji ia ka mundësuar një gjë të tillë, kam komunikuar me Agjencinë e Konkurrencës, kam komunikuar edhe me Komisionin Evropian dhe e kemi formuar një komision të përbashkët, që ta bëjmë studimin e fizibilitetit dhe pas rekomandimit të Komisionit Evropian, do të vendosim për këtë çështje.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të ftojë ministrin e Infrastrukturës dhe Transportit, për të raportuar në çdo kohë që e sheh të nevojshme, ku në këtë mënyrë bën mbikëqyrjen demokratike të ministrisë/geverisë.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese

Kryetarja njoftoi për udhëtimin zyrtar në Bruksel, në Plenumin e Energjisë, mbajtur më datë 18-20 shkurt 2019, si dhe njoftoi se në mbledhjen e ardhshme do t’i ftojë institucionet përgjegjëse për furnizim me energji dhe odat ekonomike rreth problemit me energji.

Hykmete Bajrami, tha se është e nevojshme që të ftohet ZRRE, për të diskutuar lidhur me vendimin për siguri të furnizimit me energji, e që lidhet me termocentralin e ri.

Kryetarja, tha se edhe për këtë çështje do të diskutojmë në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Staf mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA